



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Ekstra 14

Prill

2004

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i MF nr.5, datë 20.9.2001	Për pajisjen e tatimpaguesve me arka regjistruese dhe lëshimin e kuponit tatimor.....	3
Udhëzim i MF nr.12, datë 14.7.1995	Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Tatimore në qendër dhe në rrethe.....	5
Udhëzim i përbashkët nr.18, datë 18.8.1995	Mbi pajisjen me armë të efektivit të Policisë Doganore dhe asaj Tatimore.....	7
Udhëzimi i përbashkët nr.54, datë 18.3.2002	Për funksionimin e shërbimit të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore.....	7
Udhëzim i MF nr.7714/1, datë 21.12.2001	Për zbatimin e ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me ligjin nr.7923, datë 19.4.1995, ligjin nr.8594, datë 6.4.2000, ligjin nr.8630, datë 3.7.2000, ligjin nr.8826, datë 5.11.2001 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000 “Për tarifat e përdoruesve të pronësisë artistike”.....	9

UDHËZIM
Nr.5, datë 20.9.2001

PËR PAJISJEN E TATIMPAGUESVE ME ARKA REGJISTRUESE DHE LËSHIMIN E KUPONIT TATIMOR

Në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.4.2001 “Për detyrimin e lëshimit të kuponave tatimorë me anën e arkave regjistruese”, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Tatimpaguesit të cilët shesin mallra ose kryejnë furnizim shërbimesh në lokale ose njësi fikse të hapura për publikun, detyrohen të vendosin arka regjistruese për lëshimin e kuponave tatimorë.

1.1 Janë të detyruar të vendosin arkën regjistruese dhe të lëshojnë kuponin tatimor të gjithë tatimpaguesit e regjistruar në TVSH dhe që shesin mallra apo shërbime për publikun.

1.2 Gjithashtu, janë të detyruar të pajisen me arka regjistruese edhe tatimpaguesit e biznesit të vogël, të cilët furnizojnë mallra ose shërbime në njësi apo lokale të hapura për publikun.

1.3 Në zbatim të paragrafit 5 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 20.4.2001, nuk janë të detyruar të vendosin arkë regjistruese dhe të lëshojnë kupon tatimor, tatimpaguesit e regjistruar në biznesin e vogël, të cilët në kuptim të ligjit “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, ushtrojnë:

a) Veprimtari ambulante tregtare.

b) Veprimtari artizanale shërbimi (bojaxhi, hidraulik, elektrikist, lustraxhi, këpucar, marangoz, rrobaqepës, berber, llamarinist, murator, teneqepunues, riparim biçikletash).

c) Profesione të lira (agronom, ekonomist, inxhinier, mësues, veteriner, projektues, arkitekt).

2. Tatimpaguesit janë të lirë të sigurojnë vetë arkat regjistruese. Shërbimi i instalimit dhe i mirëmbajtjes së arkave regjistruese bëhet nga vetë tatimpaguesi.

Në rast se arka regjistruese gjatë punës ka pësuar defekt, riparimi për vënien në punë duhet të sigurohet nga vetë tatimpaguesi. Njoftimi për defektin e konstatuar bëhet zyrtarisht nga ana e tatimpaguesit brenda 24 orëve në degën e tatimeve dhe taksave të rrethit përkatës.

Tatimpaguesi është i detyruar të përfundojë riparimin e arkës regjistruese brenda 3 ditëve, duke evidentuar qarkullimin e realizuar gjatë kësaj periudhe nëpërmjet dëftesës tatimore. Për mosrespektimin e afatit 3-ditor të riparimit, tatimpaguesi është i detyruar t’u nënshtrohet masave administrative përkatëse për mospajisjen me arkë regjistruese.

3. Afati përfundimtar i pajisjes së njësive ose lokaleve me arkën regjistruese është 1 tetor 2001. Mbas këtij afati, ndaj të gjithë tatimpaguesve të cilët detyrohen të kenë të instaluar arkën regjistruese e të lëshojnë kuponin tatimor dhe nuk e kanë bërë një gjë të tillë, do të merren masa administrative të parashikuara në ligjin nr.7758, datë 12.10.1993 “Për dokumentimin dhe mbajtjen e llogarive për tatimet”, ndryshuar me ligjin nr.7900, datë 8.2.1995 dhe ligjin nr.8147, datë 11.9.1996.

4. Arka regjistruese e instaluar nga tatimpaguesi, në njësi ose lokal duhet të plotësojë karakteristikat teknike, siç janë përshkruar në fletët (1-5) bashkëngjitur këtij udhëzimi.

5. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Anastas Angjeli

KASA REGJISTRUESE ELEKTRONIKE

Karakteristikat teknike

- Jo më pak se 12 butona të funksionit total;

- 5 pozicione të çelësit të kontrollit;
- 3 ndarje për bankënota dhe 5 ndarje për monedha metalike;
- Funksion programi për raportin ditor dhe faturën;
- 3 butona përfundimtare (KESH, DETYRIMI, ÇEK);
- 3 mundësi llogaritje automatike të TVSH-së;
- Llogaritje manuale dhe llogaritje automatike me përqindje të fiksuar;
- Password për përdorimin e kasës;
- Funksion anulues veprimesh, funksion i faturës dhe funksion rimbursimi;
- 200 mundësi për të fiksuar në makinë çmime mallrash;
- Funksion për nxjerrjen e raportit ditor;
- Konvertim me euro;
- Tregues 4-shifror për afishimin e vitit;
- Ekran standard dhe ekran për klientin;
- Memorie fiskale;
- Memoria C-MOS RAM;
- Printeri Drum printer me kapacitet 19 shifra në radhë;
- Letra Gjerësia 57,5 +/- 0,5 mm;
- Ekрани 8 shifra;
- Kompatibël me euro;
- Përdorimi i printerit termik të shpejtë dhe silencor;
- Lidhje me "Tërheqësin e CASH" automatik për monedha dhe kartëmonedha;
- Grafike mbi fatura si: logo e përhershme, oferta speciale dhe dekorime të tjera të përkohshme;
- Memorie fiskale për vendet me sistem fiskal;
- Ushqim me tension të ulët;
- Komunikim me PC deri në 4 porta seri RS232 + 1 portë RS485 për mundësi të shumta lidhjesh;
- Trimer automatik me prerje të pjesshme dhe të plotë;
- Lidhje e lexuesve të kodeve me vija manual, fiks, lazer ose CCD;
- Lidhje me shkallë elektronike;
- Lidhje me lexues kredit kard (POS);
- Lidhje me Hayes kompatibël MODEM për transmetimin e të dhënave në linja të kyçura;
- Zmadhim i memories deri në 2 MB për artikujt, tabelat e skontos dhe mbledhjen e të dhënave;
- Pajisje me display (me karaktere të mëdha) me 2 rreshta, me nga 20 karaktere secila;
- Mund të lidhet me Thermal Slipose printer me pika për prodhimin e faturave (hyrëse, dalëse) dhe të dokumenteve të tjera;
- Lexues, shkruar për kardat me qarqe për menaxhimin e kardave për operatorët, klientët. Të besueshmit (Fidelity), kredit dhe të parapaguara;
- Tastiera: 30 butona, të mbuluara për mbrojtje nga pluhuri;
- Ekрани: 1 rresht, 12 karaktere, ekran dixhital;
- Printeri: Dixhital me shpejtësi 2 rreshta në sekondë, gjerësia 58 mm, letër rrotulluese standarde;
- Arka: 3 të ndara, 5 kuti për monedha, kartëmonedhat i merr automatikisht;
- Çelësat kontrollues: 5 kontrollime, fikse (të palëvizshme), shitje, tabela X, tabela Z, tërheqja e mallrave;
- Sektorët: 4 sektorët, çmime, shitje e çdo sektori të paravendosur;
- Funksionet e tjera: data, koha, komisione, përqindja, shpenzimet e shërbimit, faturat, mënyra e marrjes dhe heqja e shpenzimeve (p.sh. 3.6-4 ose 3.3 -3);
- Mënyra e përdorimit: shitja në një drejtim (tek ose çift), shitja e shumëzuar, ulje e çmimeve në një kohë të caktuar, ulet përqindja, shpenzimet e shërbimit të tepërta, tërheqja e mallrave, llogaritja e daljes, llogaria e hyrjes mund të plotësojnë të gjitha nevojat e shitjes;
- Korrigjimi: pastrimi, ndryshimi i gabimeve dhe eliminimi i tyre;

- Mënyra e pagesës: *cash*, me llogari bankare, me çek;
- Ora: kur aparati nuk është në punë, në ekran del ora lokale. Kur aparati është në punë në faturë del data. Koha është regjistruar deri në vitin 2000;
- Alarmi: kur ka gabim bie zilja e alarmit;
- Tabela komplekse, tabela fiskale, tabela X, tabela Z;
- Burimi i punës: me burim të drejtë dhe alternativ, 220V+/- 10%, por edhe mund të vetë ngarkohet, është i përshtatshëm për vende pa burim energjie;
- Harxhimi i energjisë: kur ngarkohet plotësisht, furnizohet me energji të plotë me ngarkesë 10V, kur nuk përdoret është 4V;
- Temperatura e ambientit dhe lagështia: nga +5 gradë celsius deri në 35 gradë celsius, lagështia < 8%.

UDHËZIM
Nr.12, datë 14.7.1995

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E POLICISË TATIMORE
NË QENDËR DHE NË RRETHE

Në zbatim të dispozitave ligjore: Dekretit nr.1074, datë 21.4.1995 miratuar me ndryshime me ligjin nr.7938, datë 24.5.1995 “Mbi shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Tatimore dhe Policisë Doganore” dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.216, datë 15.5.1995 “Mbi kriteret e organizimit të Policisë Tatimore dhe asaj Doganore”,

UDHËZIJMË:

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I POLICISË TATIMORE

1. Policia Tatimore është organ ekzekutiv i armatosur, i integruar në përbërje të organeve tatimore.

2. Policia Tatimore është e vendosur direkt nën autoritetin e Drejtorit të Drejtorisë së Tatimeve.

3. Drejtuesi i Policisë Tatimore emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Financave, ndërsa e gjithë organika tjetër e Policisë Tatimore është nën autoritetin e Drejtorit të Drejtorisë së Tatimeve.

4. Në qendër:

Në strukturën e drejtorisë së tatimeve organizohet një degë e veçantë, ajo e Policisë Tatimore që varet drejtpërdrejtë nga Drejtori i Tatimeve dhe që organizon punën e Policisë Tatimore në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë duke ushtruar kompetencat e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Në mënyrë të veçantë dega e Policisë Tatimore:

a) Përcakton metodat e punës së Policisë Tatimore;

b) Kontrollon dhe ndjek veprimtarinë e Policisë Tatimore;

c) Në kryerjen e detyrës Policia Tatimore bashkëpunon me degët e tjera të Drejtorisë së Tatimeve, organizon marrëdhënie nëpërmjet akteve të bashkëpunimit me institucionet dhe organizmat e tjerë shtetëror dhe ndjek zbatimin e tyre;

d) Organizon përgatitjen dhe ngritjen e nivelit profesional të punonjësve të Policisë Tatimore në fushën e sistemit fiskal dhe në atë të përgatitjes speciale.

5. Në çdo rreth:

Krijohet Policia Tatimore në përbërje të degës së tatimeve të rrethit, kryetari i degës së tatimeve të rrethit përcakton detyrat operative për t’u zbatuar nga Policia Tatimore në kuadrin e detyrave dhe urdhrave që shtron Drejtoria e Tatimeve.

a) Përgjegjësi i Policisë Tatimore të rrethit ka vartësi të drejtpërdrejtë nga kryetari i degës së tatimeve të rrethit. Për probleme të veçanta raporton direkt te Drejtori i Tatimeve në Ministrinë e Financave.

TË DREJTAT DHE DETYRAT E POLICISË TATIMORE

Policia Tatimore ka këto të drejta dhe detyra:

1. Të sigurojë zbatimin e ligjshmërisë në sistemin e tatim-taksave duke ekzekutuar sanksionet

ligjore të vendosura nga organet tatimore në qendër dhe në bazë dhe të pazbatuara nga personi juridik e fizik që ushtron aktivitet ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Sekuestrojnë vlerat monetare dhe materiale në bazë të urdhrit të sekuestrimit të nxjerrë nga organi epror i saj.

3. Ushtron kontroll për të zbuluar aktivitetin pa leje të ushtrimit të profesionit dhe që është i paregjistruar në organet tatimore duke ndjekur zbatimin e vendimeve të këtyre organeve për mbylljen e veprimtarisë pa leje.

Për të tilla raste me urdhër të organit epror sekuestron të ardhurat e përfituara në mënyrë të paligjshme dhe mallrat objekt i këtij aktiviteti, si dhe bën ekzekutimin e masave të tjera ndëshkuese.

4. Merr pjesë së bashku me inspektorët e organeve tatimore në kontrollin e subjekteve ekonomike, në kontrollet e veçanta, si: mbajtjen e dokumenteve të kontabilitetit, regjistrimin e rregullt të tyre dhe pasqyrimin e drejtë në bilancin kontabël, kontrollon lëshimin e faturave, përdorimin e arkave regjistruese dhe lëshimin e kuponave tatimorë.

5. Të kontrollojë dokumentin e lëvizjes së mallrave dhe udhëtarëve në të gjitha llojet e transportit, të bëjë kontrolle fizike mbi vërtetësinë e përmbajtjes së dokumentacionit shoqërues.

6. Kontrolli në sektorin e transportit në të gjitha rastet do të bëhet nga grupi përkatës në përbërjen e të cilit do të jetë edhe një inspektor i tatimeve.

7. Merr pjesë në kontrollin e deklaratave tatimore në mbështetje të operacioneve të verifikimit që zbatojnë inspektorët e tatimeve.

8. Bllokon, kur e sheh të nevojshme, të gjithë dokumentacionin që ka lidhje me veprimtarinë që kontrollohet. Për veprimet dhe rezultatet e kontrollit punonjësit e Policisë Tatimore mbajnë procesverbalet përkatëse dhe informojnë me shkrim organin epror të tyre brenda 24 orëve, i cili vendos për sanksionet dhe kundërvajtjet administrative, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

9. Mbledh informacione dhe të dhëna që lidhen me veprimtarinë e tatimpaguesve pranë administratave dhe institucioneve publike, si:

- organet doganore,
- institucioneve bankare dhe financiare,
- institutit të Sigurimeve Shoqërore,
- subjekteve ekonomike, publike ose private,

me qëllim që të bëhet plotësimi dhe ballafaqimi i të dhënave të mbledhura me informacionet që disponojnë organet tatimore.

10. Punonjësit e policisë tatimore mund të propozojnë, por nuk mund të përcaktojnë masën e tatimeve ose sanksioneve dhe masat e tjera ndëshkimore që merren ndaj tatimpaguesve.

RREGULLA TË VEÇANTA

1. Organet e Policisë Tatimore pajisen me mjete kryesore, armatimi dhe inventari, të cilat i përdorin sipas kriterëve dhe rregullave përkatëse.

2. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre organet e Policisë Tatimore mbajnë dhe paraqesin dokumente identifikimi të miratuara nga Ministri i Financave dhe për çdo rast largimi nga puna, kryetari degës së tatimeve dhe përgjegjësi i Policisë Tatimore të tërheqin nga inspektori i larguar materialet, që kishte në inventar, si dhe dokumentet identifikuese të policisë duke zbatuar rregullat përkatëse për administrimin e armëve.

3. Policia Tatimore bashkëpunon me Policinë Doganore, dhe në raste të duhura kërkon ndihmën e organeve të rendit sipas protokoll marrëveshjeve të lidhura.

4. Shpenzimet për mbajtjen e Policisë Tatimore përfshihen në buxhetin e shpenzimeve të miratuara për organet tatimore në qendër dhe në rrethe.

5. Punonjësit e Policisë Tatimore për veprimet e kryera në kundërshtim me përmbushjen e detyrës, kur ato nuk bëjnë veprë penale, mbajnë përgjegjësi administrative sipas dispozitave në fuqi.

MINISTRI
Dylber Vrioni

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr.18, datë 18.8.1995

MBI PAJISJEN ME ARMË TË EFEKTIVIT TË POLICISË DOGANORE DHE TATIMORE

Në zbatim të ligjit nr.7566, datë 25.5.1992 “Për armët”, të dekretit nr.1074, datë 21.4.1995 “Për shpërndarjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Doganore dhe Tatimore”, vendimet e Këshillit të Ministrave nr.275, datë 25.6.1992 “Mbi rregullat e administrimit dhe të kontrollit të armëve për personat fizikë e juridikë”, vendimet e Këshillit të Ministrave nr.216, datë 15.5.1995 “Për kriteret e organizimit të Policisë Doganore e Tatimore”,

UDHËZOJMË:

1. Pajisja me armë zjarri i efektivit të Policisë Tatimore dhe Doganore do të bëhet nga komisaritetet e policisë në rrethe dhe në Tiranë në komisaritin nr.1.

Dhënia e armatimit në qendër dhe në bazë do të bëhet kundrejt autorizimit nominativ të lëshuar nga Ministri i Financave, ku do të përcaktohet funksioni organik i efektivit të Policisë Tatimore dhe Doganore (oficerë dhe nënoficerë). Armatimi të jepet individualisht nga shefi ose tekniku i armatimit të organit të brendshëm, pasi të jetë siglur autorizimi nga shefi i komisaritetit sipas rregullave.

2. Oficerët, nënoficerët e Policisë Tatimore dhe Doganore të mbajnë gjithmonë me vete pistoletat (pa fishekë në fole e këllëf të rregullt).

3. Në rastet e largimeve, transferimeve, pushimeve nga puna të punonjësve të Policisë Tatimore dhe Doganore të pajisur me armë zjarri, degët e Policisë Tatimore dhe Doganore vënë në dijeni menjëherë organin përkatës që ka bërë furnizimin me armë në momentin e komunikimit të urdhrat dhe marrin masa për marrjen e armës konform rregullave, ndiqet penalisht nga organet kompetente për armëmbajtje pa leje.

4. Efektivi i Policisë Tatimore dhe Doganore të pajiset me pistoletë M 54. Për çdo pistoletë të jepen 14 copë fishekë.

5. Për çdo ndryshim në strukturat organike të Policisë Tatimore dhe Doganore, Ministria e Financave njofton me shkrim Ministrinë e Brendshme.

6. Në zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen komisaritetet e policisë, degët e policisë tatimore dhe doganore në rrethe. Për kontrollin ngarkohen në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Personelit, në Ministrinë e Brendshme, Drejtoria e Policisë së Rëndit dhe Drejtoria Ekonomike.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Dylber Vrioni

MINISTRI I BRENDSHËM
Agron Musaraj

UDHËZIMI I PËRBASHKËT
Nr.54, datë 18.3.2002

PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË POLICISË GJYQËSORE NË POLICINË TATIMORE

Mbështetur në nenin 17 të ligjit nr.8677, datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”:

URDHËROJMË:

1. Shërbimet e Policisë Gjyqësore në rajone e të Policisë Tatimore ushtrojnë veprimtari procedurale sipas kompetencave lëndore dhe/ose tokësore të tyre brenda juridiksionit të prokurorive të

ngritura pranë gjykatës së shkallës së parë.

2. Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Drejtorinë e Policisë Tatimore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre procedurale në të gjithë territorin e vendit, në çdo rast brenda juridiksionit dhe nën drejtimin e prokurorisë kompetente.

3. Shërbimet e Policisë Gjyqësore gjatë ushtrimit të veprimtarisë procedurale ruajnë hierarkinë që kanë në ndërtimin administrativ të strukturave të Policisë Tatimore.

4. Drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore përgjigjen përpara prokurorëve që drejtojnë hetimet për zbatimin e detyrave prej vartësve të tyre.

5. Me autorizim të prokurorit që drejton hetimet, drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore kontrollojnë realizimin dhe afatet e zbatimit të detyrave të urdhëruara dhe/ose të deleguara.

6. Drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore të të gjitha niveleve u paraqesin menjëherë titullarëve të prokurorëve kompetentë listën emërore të oficerëve të Policisë Gjyqësore që janë në varësi të tyre, duke përcaktuar rolin dhe profilizimin e secilit.

7. Drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore njoftojnë 10 ditë përpara drejtuesit e prokurorive kompetente në rastet kur transferohen oficerët e Policisë Gjyqësore për nevoja pune.

8. Kur gjykohet bashkërisht se transferimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore mund të sjellin pasoja në ecurinë e hetimeve vendoset pezullimi i përkohshëm i transferimeve deri në përfundim të hetimeve.

9. Oficerët dhe agjentët e shërbimeve gjyqësore në Policinë Tatimore realizojnë veprimtarinë e tyre procedurale me iniciativë, urdhër apo delegim të prokurorit dhe mbajnë përgjegjësi për zbulimin, hetimin dhe dokumentimin në rrugë procedurale të veprave penale që do të delegohen.

10. Aktet procedurale të përpiluara nga oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore i referohen prokurorit kompetent, sipas mënyrës dhe kërkesave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Këto akte dërgohen menjëherë bashkëngjitur me shkresë të drejtuesit të shërbimeve të Policisë Gjyqësore ku janë kryer veprimet procedurale, por jo më vonë se 24 orë nga momenti i marrjes dijeni për veprën penale.

11. Gjatë fazave të hetimeve paraprake, hetimi gjyqësor e deri sa gjykata jep vendim të formës së prerë, oficerët e Policisë Gjyqësore që hetojnë ose kanë kryer hetimet përgjigjen para prokurorëve kompetentë për kryerjen me cilësi të detyrave që mund t'u ngarkohen në vazhdimësi.

12. Kur prokurori i çështjes dhe drejtuesi i shërbimit të Policisë Gjyqësore e vlerësojnë të nevojshme, oficerët e Policisë Gjyqësore që kanë kryer hetimet marrin pjesë dhe gjatë seancave të hetimit gjyqësor, për të ndihmuar prokurorin në paraqitjen e provave.

13. Për ecurinë e hetimeve, si dhe para marrjes së vendimeve për pushimin, pezullimin apo dërgimin për gjykim të procedimeve, prokurori kompetent organizon analiza, në të cilat raportojnë drejtuesit dhe oficerët e shërbimeve të Policisë Gjyqësore që kanë bërë hetimin.

14. Në rastet kur në të njëjtat hetime janë përfshirë edhe oficerë të seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorive, respektohen kërkesat e përcaktuara në pikat 11,12 dhe 13 të këtij udhëzimi.

15. Shërbimet e Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore dhe seksionet e Policisë Gjyqësore pranë prokurorive, çdo tre muaj shkëmbejnë informacione ndërmjet tyre për çështje që lidhen me:

- gjendjen e përgjithshme të kriminalitetit,
- tendencat më shqetësuese të tij,
- marrjen e masave parandaluese,
- si dhe çdo problem tjetër që është me interes, në kuadrin e përgjithshëm të punës për parandalimin e veprimtarive kriminale.

16. Shkëmbimi i ndërsjellë i informacioneve, nëpërmjet shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore dhe i seksioneve të Policisë Gjyqësore pranë prokurorive realizohet për verifikime që lidhen me:

- implikime të tjera për autorët ose autorë të tjerë të veprave penale;
- rrethana apo të dhëna të reja në funksion të procedimit penal;
- si dhe marrjen e detyrimeve reciproke, të përbashkëta ose të bashkërenduara.

17. Veprimtaria e përmendur në pikën 16 të këtij udhëzimi realizohet nën autoritetin dhe

drejtimin e prokurorit kompetent, në përputhje me normat e vendosura në Kodin e Procedurës Penale.

18. Prokuroritë e ngritura pranë gjykatës së shkallës së parë, çdo vit në bashkëpunim me drejtuesit e shërbimeve të Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore, planifikojnë dhe marrin masa për organizimin, bashkërendimin dhe kryerjen e veprimtarive që kanë për qëllim trajnimin e vazhdueshëm juridik e profesional të oficerëve dhe agentëve të Policisë Gjyqësore.

19. Me këtë udhëzim njihen prokurorët, personeli i seksionit të Policisë Gjyqësore, si dhe personeli i shërbimit të Policisë Gjyqësore.

20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen prokurorët, drejtuesit e seksioneve dhe shërbimet e Policisë Gjyqësore, si dhe oficerët dhe agentët e Policisë Gjyqësore në Policinë Tatimore.

21. Për kontrollin dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Prokuroria e Përgjithshme, prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë, si dhe Drejtoria e Policisë Tatimore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Kastriot Islami

PROKURORI I PËRGJITHSHËM
Arben Rakipi

UDHËZIM
Nr.7714/1, datë 21.12.2001

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7564, DATË 19.5.1992 “PËR TË DREJTËN E AUTORIT”,
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7923, DATË 19.4.1995, LIGJIN NR.8594, DATË 6.4.2000,
LIGJIN NR. 8630, DATË 3.7.2000, LIGJIN NR.8826, DATË 5.11.2001 TË VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.309, DATË 13.6.2000 “PËR TARIFAT E PËRDORUESVE
TË PRONËSISË ARTISTIKE”**

Në mbështetje të nenit 102 dhe në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Konventat Ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 “Për të drejtën e autorit”, ndryshuar me ligjet nr.7923, datë 19.4.1995, nr.8594, datë 6.4.2000, nr.8630, datë 3.7.2000 dhe 8826, datë 5.11.2001 dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000 “Për tarifatat e përdoruesve të pronësisë artistike”, Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Organet tatimore në qendër dhe në rrethe të marrin masa për zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e së drejtës së autorit, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave nga strukturat e Policisë Tatimore.

Në Drejtorinë e Policisë Tatimore në qendër, caktohet një inspektor për ndjekjen dhe koordinimin e detyrave për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e autorit”, ndërsa në degët rajonale të Policisë Tatimore të caktohen dhe të specializohen grupe të veçanta të kontrollit për zbatimin e këtij ligji. Me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit, Policia Tatimore bashkëpunon me shoqatat përkatëse të mbrojtjes së së drejtës së autorit.

2. Degët e tatimeve në rrethe të evidentojnë tatimpaguesit, të cilët ushtrojnë aktivitet në fushat e pronësisë intelektuale të artit, sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000.

3. Policia Tatimore dhe organet doganore, në zbatim të legjislacionit në fuqi, nuk lejon zhvillimin e veprimtarisë nga subjektet të cilat përdorin pronësinë intelektuale në fushën e artit, si subjekte prodhuese, importuese, përdorues, shitës apo qiradhënës dhe të cilët nuk kanë nënshkruar kontrata me shoqëritë e mbrojtjes së së drejtave të autorit, si dhe të ndalojnë prodhimin, importimin, tregtimin e kasetave, videokasetave, kompaktdisqeve etj., që janë të pajisura me pullën përkatëse të shoqërive të mbrojtjes së të drejtave të autorit.

4. Me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e së drejtës së autorit, për subjektet e përmendura në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000, degët e tatimeve dhe taksave në rrethe kërkojnë:

- nga tatimpaguesit e biznesit të vogël, në momentin e regjistrimit dhe reregjistrimit në organin tatimor, kontratën e lidhur me shoqërinë e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pagesën për këto kontrata, si dhe pagesën për blerjen e pullave për pajisjen e kasetave, vidiokasetave dhe kompaktdisqeve, nëse prodhojnë, importojnë këto mallra.

- nga tatimpaguesit e biznesit të madh, në momentin e dorëzimit të bilancit në organin tatimor, kontratën e lidhur me shoqërinë e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pagesën për këto kontrata, si dhe pagesën për blerjen e pullave për pajisjen e kasetave, videokasetave dhe kompaktdisqeve, nëse prodhojnë, importojnë apo tregtojnë këto mallra.

5. Policia Tatimore ushtron kontrole te përdoruesit e pronësisë intelektuale prodhuese, importuese, shitës apo dhënës me qira të kasetave, videokasetave, kompaktdisqeve etj., për pajisjen e tyre me pullën e shoqërisë së mbrojtjes së të drejtave të autorit, si dhe nëse këto subjekte kanë nënshkruar kontrata me këto shoqëri.

6. Të kontrollohet dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000, të ndalohet zhvillimi i spektakleve, shfaqjeve kinematografike etj., pa lejen e autorëve të shoqërisë që autoritetet i kanë kaluar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

7. Në zbatim të ligjit nr.8826, datë 5.11.2001 "Për disa shtesa në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit"", përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) përdorimi i pronësisë artistike nga subjektet juridike dhe fizike, pa lejen e autorit apo pa kontratë me shoqëritë e mbrojtjes së të drejtave të autorit, shqiptar apo i huaj, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë;

b) mospagimi në afat i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave apo i autorizimeve midis autorëve shqiptarë apo të huaj, ose shoqërisë që mbron të drejtat e tyre, me përdoruesit e pronësisë artistike.

8. Shkeljet e parashikuara në ligjin nr.8826, datë 5.11.2001, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga punonjësit e Policisë Tatimore, duke kërkuar përveç pagimit të gjobës, edhe arkëtimin e të drejtës së autorit sipas këtij ligji. Nga gjobat e vjela, 60 për qind kalojnë në Buxhetin e Shtetit dhe 40 për qind në llogari të shoqërisë për mbrojtjen e së drejtës së autorëve.

Procedurat e ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Anastas Angjeli

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
13.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA

14.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
15.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

Së shpejti në botim, përmbledhje në fushën e taksave dhe tatimeve

Doli nga shtypi më 5.3.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2004

Çmimi 100 lekë